

Instruksione mbi licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime

Baza ligjore:

- Ligji Nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”
- Vendimi Këshillit të Ministrave, Nr 164 Datë 28.01.2008, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime”
- Rregullore mbi testimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime.
- Formulari i aplikimit për pajisjen me licence “vlerësues demesh në sigurime”

Papajtueshmëria me profesionin e vlerësuesit të dëmeve në sigurime

Ne interpretim të pikës 2 dhe 3 të VKM Nr 164 Datë 28.01.2008, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime” nuk licencohet si vlerësues:

- zoteruesi i drejtperdrejte dhe zoteruesi jo i drejtperdrejte i aksioneve të shoqërisë së sigurimit/risigurimit;
- drejtori i përgjithshëm i shoqërisë së sigurimit/risigurimit;
- anetari i keshillit mbikqyres të shoqërisë së sigurimit/risigurimit;
- anetari i komitetit të kontrollit të brendshëm të shoqërisë së sigurimit/risigurimit,
- aktuari i shoqërisë së sigurimit/risigurimit.

Lloji i licences:

1. Licenca është e ndare:

- vlerësues i dëmeve për jete dhe
- vlerësues i dëmeve për jo-jete

Vlerësuesi i licensuar i dëmeve nuk mund të ushtrojë njëkohësisht profesionin e tij në vlerësimin e dëmeve që mbulon sigurimi i jojetes dhe jetes.

2. Vlerësuesit e dëmeve të sigurimit të jojetes, në përputhje me kërkesën, mund të licensohen si:

- vlerësues i licensuar i dëmeve materiale (motorike dhe të pronës), ose
- vlerësues i licensuar i dëmeve shëndetsore, ose
- të dyja me siper.

Gjykimi ne varesi te arsimit, kualifikimit dhe eksperiences

Licensimi i vleresuesve te demeve ne sigurime, ne perputhje me kerkesen e aplikantit, behet duke vleresuar:

1. *Arsimimin,*

Departamenti i licensimit duke vleresuar dokumentacionin e paraqitur per arsimimin e aplikantit i propozon Bordit te AMF per dhenie license:

- a. te vleresuesit te demeve materiale dhe demeve shendetsore per sigurimin e jojetes, aplikantit me arsim te larte.
- b. te vleresuesit te demeve shendetsore per sigurimin e jetes, aplikantit me arsim te larte me profil mjeksor.

2. *kualifikimin,*

- a. Nese aplikanti ka kualifikim te specializuar per vleresimin e demeve te paraqitur me dokument, dhenia e llojit te licenses do jete ne varesi te ketij kualifikimi.
- b. Kualifikimi i specializuar duhet te jete me afat jo me pak se 6 muaj.

3. *Eksperencen,*

- a. Nese aplikanti ka eksperience mbi 5 vjet ne vleresimin e demeve materiale, licensa percakton aktivitet vetem per deme materiale,
- b. Nese aplikanti ka eksperience mbi 5 vjet ne vleresimin e demeve shendetsore, licensa percakton aktivitet per deme shendetsore dhe/ose deme materiale sipas kerkeses se aplikantit.
- c. Nese aplikanti ka eksperience mbi 5 vjet ne vleresimin e demeve shendetsore ne sigurimin e jetes, licensa percakton aktivitetin e vleresimit te demeve te jetes.

Kriteri baze per trajtimin e kerkeses se aplikantit (plotesimi i te pakten 1 prej kritereve te meposhtme)

- Përvojë profesionale jo më pak **se pesë vjet**, në mënyrë të vazhdueshme, në fushën e sigurimeve ose te risigurimeve, e lidhur me procesin e vlerësimit

Përvojë profesionale në fushën e sigurimeve ose te risigurimeve, e lidhur me procesin e vlerësimit do kuptohet:

puna e kryer ne strukturat, qe perfaqesojne funksione themelore te biznesit te sigurimeve, prane shoqerive te sigurimit, ndermjetesve ne sigurime, Rregullatorit, Byrose shqiptare te sigurimit apo organet shteterore.

Vertetohet nga dokumenti i leshuar nga punedhenesi (shoqeri sigurimi, ndermjete ne sigurime, rregullatori, gjykata, byroja shqiptare e sigurimeve, apo ndonje institucion tjeter.

Dokumenti shoqerohet nga rekomandimi ku duhet te dale ne pah vleresimi mbi punen e bere nga aplikanti nga pikepamja sasiore dhe cilesore.

- Përfundimi i studimeve të specializuara të larta në sigurime, risigurime apo të lidhura me procesin e dëmshpërblimit ose ndërmjetësimit në sigurime.

Ky kriter do te gjykohe rast pas rasti dhe do te vertetohet nepermjet Diplomes/ cerifikates/deshmise, mbi kryerjen e studimeve te specializuara. Dokumenti do te shoqerohet nga lista e kurseve te ndjekura dhe vleresimi perkates.

- Të këtë kryer kualifikim profesional si dhe të këtë përvojë profesionale në fushën e sigurimeve ose risigurimeve, jo më pak **se dy vjet**.

Vertetohet nepermjet:

- Dokumentit për përfundimin e një kualifikimi për vlerësimin e dëmeve në sigurime, pranë një instituti trajnimi në sigurime, brenda ose jashtë vendit, me një program të njohur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (kursi te jete jo me pak se 6 muaj), si dhe
- Dokumentin për përvojë profesionale të vërtetuar nga punëdhënësi perkates.

Dokumentacioni që shoqeron kerkesen per aplikim:

Formulari i aplikimit per pajisjen me licence “vleresues demesh ne sigurime” shoqerohet nga dokumentacioni si me poshte (pervec dokumentit te mesiperm):

Per aplikantin si **person fizik**

A. Dokumentacioni i përgjithshëm:

K e r k e s a t	D o k u m e n t i
a. Dokument identifikimi	Certifikatë personale me fotografi e periudhës jo më e vjetër se tre muajt e fundit para aplikimit,/ pasaportë/ letër njoftimi
b Vërtetim origjinal ose kopje e noterizuar, që provon se ka shlyer detyrimet financiare, sipas legjislacionit në fuqi, me afat kohor jo më vonë se tre muaj nga data e dorëzimit të kërkesës	Vërtetim nga organet tatimore Vertetim nga Regjistri I kredive per borxhin ndaj sistemit bankar

c. Diplomën e shkollës së lartë	Origjinale ose kopje të noterizuar
d. Dokument që vërteton përvojën në punë, sipas profesionit	CV
e. Deklaratën e interesit se do ta ushtrojë veprimtarinë në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me standartet profesionale	Deklarate e nënshkruar nga vetë personi
f. Te pakten nje leter rekomandimi	Cdo leter rekomdimi duhet te permbaje te dhena per rekomaduesin lehtesisht te aksesueshme.
g. Të ketë policë sigurimi në një shoqëri sigurimi të përgjegjësive profesionale ndaj palëve të treta, për rastet e shkeljeve gjatë ushtrimit të veprimtarisë, me limit për një ngjarje sigurimi 30 000 000 Lekë dhe limit maksimal 100 000 000 Lekë, për një periudhë kohore një vjecare	Polica e sigurimit

B. Dokumentacion që vërteton besueshmërinë:

K e r k e s a	Dokumenti
a.Te dhena mbi gjendjen gjyqesore	Vetedeklarim mbi gjendjen gjyqesore
b. Deklaratë që nuk zotëron aksione ose nuk ka lidhje biznesi, të drejtëpërdrejta ose të tërthorta, me shoqëritë e sigurimit	Deklarate
c. Vërtetimi, i cili provon që asetet e tij nuk janë deklaruar në proces falimentimi	Vërtetim nga organet tatimore
e. Deklaratën noteriale, se gjatë 5 viteve të fundit, para datës së paraqitjes së aplikimit, nuk ka qënë anëtar i këshillave mbikqyrëse apo drejtues i shoqërive, në proces falimentimi apo likuidimi	Deklaratë noteriale

Dokumentacioni që duhet të plotësojnë aplikuesit për licensë agjenti si **person juridik** janë si më poshtë:

A. Dokumentacioni i përgjithshëm:

K e r k e s a	Dokumenti
a. Të dhëna identifikuese për drejtorin e shoqërisë dhe antarët e organit më të lartë drejtues	
b Vendimin e regjistrimit në gjykatë, statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë	Origjinale ose kopje të noterizuar
c. Te dhena mbi kapitalin dhe strukturen aksionere	Statut, bilanc
d.Vërtetimin, se nuk është debitor ndaj organeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore, me afat kohor jo më vonë se tre muaj nga data e dorëzimit të kërkesës	Vertetim nga tatim taksat
e.Dokumentacionin, i cili vërteton se administratori dhe çdo i punësuar i shoqërisë, që do të përfshihet direkt në veprimtarinë e vlerësimit të dëmit, është i diplomuar dhe ka përvojën e aftësitë profesionale,	CV
f. Deklaratën e drejtuesit ligjor, se shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me standartet profesionale.	Deklarate
g. Te kete police sigurimi në një shoqëri sigurimi të përgjegjësisë profesionale ndaj palëve të treta, për rastet e shkeljeve gjatë ushtrimit të veprimtarisë, me limit për një ngjarje sigurimi 30 000 000 Lekë dhe limit maksimal 100 000 000 Lekë, për një periudhë kohore një vjecare	Polica e sigurimit

B. Dokumentacion që vërteton besueshmërinë:

	Dokumenti
a. Deklaratën e drejtuesit ligjor, që shoqëria nuk zotëron aksione ose nuk ka lidhje biznesi, te drejtëpërdrejta ose të tërthorta me shoqëritë e sigurimi	
b. Vërtetimi, i cili provon që asetet e tij nuk janë deklaruar në proces falimentimi	Vërtetim nga organet tatimore Vertetim nga QKR

Nese aplikanti nuk ploteson kriteret e percaktuara ne VKM, Departamenti i kthen pergjigje per mospermbushje te kriterëve per licencim.

Testimi

Kusht per licencimin e vleresuesve te demeve, pervec dokumentacionit te percaktuar mesiper, eshte **kalimi me sukses i testimit**, te organizuar ne perputhje me rregulloren e testimit.

1. Ne testim do te futen vetem ata aplikante qe kane plotesuar dokumentacionin.
2. Drejtoria e licensimit pergatit dosjet te cilat kane dokumentacionin e plote.
3. Testimi do behet te enjten e fundit te cdo muaji.
4. Materiali per testim eshte listuar ne rregulloren e testimit. Materialet e tjera publikohen ne faqen zyrtare te AMF.
5. Aplikanti njoftohet dy jave para per rregullsine e dokumentacionit.
6. Njoftohet Kryetari i AMF per kandidaturat e testimit. Kryetari mbledh komisionin e testimit.
7. Testimi i pare do jete data 26.06.2008.

Polica e sigurimit per pergjegjesite profesionale

Polica e sigurimit per pergjegjesite profesionale do te jete pjese e dokumentacionit per licencim pas kalimit me sukses te testit.

Rastet e refuzimit te licences:

1. nuk permbush kerkesat e ketij vendimi;
2. nuk kalon me sukses testimin per njohuritë, sipas pikës 14, të ketij vendimi;
3. ka kryer shkelje të kuadrit ligjor në fushën e sigurimeve.